



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199527

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05739547

Ac.nr.4500/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca – Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I..., H..., Z..., H... dhe I... B.... të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson N... H..., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F... B.. zyrtare e lart ligjore, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2957/10 i datës 19.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësve I..., H..., Z..., H... dhe I... B... të gjithë nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2957/10 i datës 19.02.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2957/10 i datës 19.02.2020, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve I..., H..., H... dhe I... B... të gjithë nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që të ju njihet e drejta e pronësisë në pronën e lirë të paditurës Komuna e Prishtinës, si kompensim real për paluajtshmërinë e nacionalizuar, me natyrë apo në të holla, që do të përcaktohet nga eksperti gjeodet, agronom dhe financiar përkatës, për caktimin dhe evidentimin e ngastrës së lirë të paditurës, me sipërfaqe të njëjtë, me bonitet të ngjashëm, kundrejt pronës së nacionalizuar, si paluajtshmëria lëndore që gjendet në Prishtinë, në sipërfaqe prej 0.38.43 ha, të njëjtën me sipërfaqe, bonitet dhe kulturë si parcela kadastrale-2, në sipërfaqe prej 0.38.43, me kulturë parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona urbane, shfrytëzimi aktual i pronës arë e klasit të tretë, vendi i quajtur “Mahalla e Muhaxherëve”, e evidentuar si njësi kadastrale P-71914059-.....-2, në posedim të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Zona Kadastrale Prishtinë dhe shpenzimet e procedurës,

krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë paditësit nëpërmes përfaqësueses së autorizuar, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet si e bazuar apo i njëjti të priset dhe çështjen t'ia kthej në rishqyrtim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit I..., H..., Z..., H... dhe I... B... të gjithë nga P..., me datën 30.12.2010, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë kundër të paditurës, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që paditëseve t'iu njoh të drejtën e pronësisë në pronën e lirë të t 'paditurës Komuna e Prishtinës, si kompensim real për paluajtshmërinë e nacionalizuar, me natyrë apo në të holla për ngastrën kadastrale nr.-2, në sipërfaqe prej 0.38.43, me kulturë parcelë, lloji i pronës shoqërore, zona urbane, shfrytëzimi aktual i pronës, arë e klasit të tretë, vendi i quajtur "Mahalla e Muhaxherëve", me kërkesë dhe arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2957/10 i datës 19.02.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara dhe nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësit janë trashëgimtar legjitim të tani të ndjerit I... B.. i cili ka ndërruar jetë në vitin 1977 dhe se i njëjti ka qenë pronar i pronës lëndore sipas fletës poseduese me Nr. 2731 e datës 16.02.1966. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti nëse paditësve u takon e drejta e pronësisë në pronën e paditurës, si kompensim real për paluajtshmërinë e nacionalizuar në ngastrën kadastrale nr.-2, në sipërfaqe prej 0.38.43. Për vërtetimin e fakteve kontestuese në me të palëve ndërgjyqëse gjykata ka bëtë nxjerrjen e provave materiale përfshirë edhe ekspertizën e gjeodezisë si ka dëgjuar paditësin I... B... në cilësi të palës. Mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar gjykata e ka arsyetuar se paditësit nuk kanë mundur fare të parashtrojnë kërkesë për kthimin e pronës lëndore të eksproprijuar respektivisht zëvendësimin e të njëjtës me një pronë të lirë me bonitet dhe sipërfaqe të njëjtë si prona lëndore, pasi që në rastin konkret paditësve ju ka kaluar mbi dhjetë vjet nga dita kur vendimi mbi eksproprijimin, ka marrë formën e prerë, andaj në këtë rast paditësit nuk

kanë mundur të paraqesin kërkesa si në padi dhe precizimin e saj, ngase paditësit nuk e kanë provuar me asnjë provë shkresore nëse deri në vitin 2010, kanë ndërmarrë ndonjë veprim për kthimin e pronës së ekspropriuar apo anulimin e vendimit për ekspropriim apo zëvendësimin e pronës lëndore me pronë të lirë të paditurës që nga viti 1966, kur edhe është bërë ekspropriimi, nga çka rezulton se kanë kaluar mbi 40 vite, që paditësit nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për ta ankimuar vendimin mbi ekspropriimin e pronës lëndore ndaj organit shpronësues. Tutje ka shtuar se duke u bazuar nënin 2 paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), në të cilin përcaktohet se: *“Në procedurë kontestimore, gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*, e meqë paditësit në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të LPK-së, e kanë pas për detyrë që të paraqesin fakte mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre duke i propozuar prova gjykatës nga të cilat do të mund konstatoheshin pretendimet lidhur me kërkesat e tyre, mirëpo paditësit në këtë rast kanë dështuar që pretendimet e tyre lidhur me kërkesat e paraqitura ti mbështesin me fakte, andaj ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazuar.

Për bazën juridike gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 21 i Ligjit mbi Ekspropriimin, (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78), e lidhur me nenin 2 par. 1 dhe nenit 7 të LPK-së, ndërsa për shpenzime të procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësve të parashtruar kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye ka gjetur se aktgjykimi i atakuar duhet të vërtetohet në tërësi.

Pretendimi ankimor i palës ankuese se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Rrjedhimisht është i paqëndrueshëm edhe pretendimi ankimor i paditësve për shkelje të dispozitave procedurale nga neni 181.1; 182 dhe 183 lidhur me nenin 391 pika f) të LPK-së, për faktin se një pretendim i tillë është paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar vetëm duke u përmendur dispozitat pa

specifikuar ndonjë rrethanë se ku konsiston shkelja e atyre dispozitave dhe pa precizuar ndonjë rrethanë e cila do e arsyetonte pretendimin e tillë ankimor .

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit të gjitha faktet thelbësore kontestuese i ka provuar me mjete të përshtatshme dhe të besueshme provuese dhe rrjedhimisht edhe i ka arsyetuar të njëjtat në raport me normën e zbatuar. Gjykata në procedurën e provave ka vërtetuar faktin se me aktvendimin e të paditurës Nr. 15246/66 është bartur e drejta e shfrytëzimit të tokës e evidencuar si ngastër kadastrale, në sipërfaqe 0,38.43 ha, nga shfrytëzuesi I... (Sh...) B..., tani i ndjerë - paraardhës i paditësve në Ndërmarrjen për Ekonomi Banesore dhe Komunale në Prishtinë për nevojat e ndërtimit të lagjes banesore “Ulpiana” në Prishtinë, ndërsa me aktvendimin Nr.05/2-5265/67 i datës 18.03.1967 është caktuar lartësia e kompensimit të tokës së nacionalizuar lëndore, në lartësi prej 5,765.50 dinarë të ri dhe se e paditura nëpërmes Drejtorisë së Financave të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga llogaria me Nr. 684-783/2-316, e ka kompensuar (paguar) paraardhësin e paditësve I... B..., në shumën e lartcekur, në emër të kompensimit të tokës së nacionalizuar dhe atë me një këst, me para të gatshme. Përveç kësaj gjykata ka vërtetuar faktin se edhe pronari i deriatëhershëm i ngastrës lëndore deri në vitin 1967 kur është bërë bartja e të drejtës së shfrytëzimit të tokës në Ndërmarrjen për Ekonomi Banesore dhe Komunale në Prishtinë, I... B... dhe as paraardhësit e tij- këtu paditësit, nuk kanë parashtruar në procedurë administrative ndonjë kërkesë për anulimin e vendimit mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës si dhe nuk kanë parashtruar ankesë ndaj të njëjtit aktvendim as në afatin objektiv, para se të kalojnë 10 vite nga data e marrjes së aktvendimit. Për më tepër nga shkresat e lëndës rezulton se paraardhësi i paditësve edhe është kompensuar për pasurinë e nacionalizuar.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e asaj gjykate për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo-juridike nga ka rrjedhur pathemelësia e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 21 të Ligjit mbi Eksproprijimin, (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78) me të cilën përcaktohet se: *“Shfrytëzuesi i ish eksproprijimit, gjersa vendimi të merr formë të prerë mund të heqë dorë tërësisht ose pjesërisht nga propozimi i eksproprijimit. Nuk aprovohet dorëheqja e pjesërishtme e eksproprijimit nëse me këtë kishin me u cenuar të drejtat e pronarit të pasurisë së patundshme edhe nëse pronari paraqet ankesë të tillë. Nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit dhe pronari i përparshëm atë e kërkojnë së bashku, anulohet vendimi në formën e prerë mbi eksproprijimin. Vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm, të pasurisë së patundshme të eksproprijuar, nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin prej 3 (tri) vitesh ç ‘prej se vendimi ka marrë formë të prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punimet e nevojshme në atë objekt. Pasi të kalojnë dhjetë vjet nga dita kur vendimi ka marrë formë të prerë mbi eksproprijimin nuk mund të paraqitet kërkesa për anulimin e atij vendimi.”* Me dispozitën e nenit 379 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është paraparë se: *“Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, me anë të pajtimit para gjykatës apo para organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet, edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashkrimi”*.

Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara ligjore e bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar rrethanat dhe faktet kur ka gjetur se paditësit kanë

humbur çdo afat ligjor për të kërkuar kompensim të çfarëdo forme çoftë në emër të pasurisë lëndore dhe se me të drejtë ka vlerësuar se në rast të pakënaqësisë me vendimin e të paditurës, paraardhësi i paditësve apo eventualisht paditësit kanë qenë të kushtëzuar me aftin ligjor në rastin konkret prej 10 vitesh të paraparë me dispozitat e sipërcituara ligjore për të kërkuar anulimin e këtij vendimi.

Pathemelësia e kërkesëpadisë së paditësve gjenë mbështetje edhe në dispozitën e nenit 44 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore me të cilën përcaktohet se: *“E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësi shoqërore”*, kjo për faktin se ashtu siç edhe ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, pararendësi juridik i paditëseve e ka humbur të drejtën e pronësisë në momentin kur prona e tij ka kaluar në pronësi shoqërore, ndërsa në anën tjetër paditësit gjykatës nuk i kanë ofruar ndonjë provë nëse pronari i deriatëhershëm i ngastrës lëndore deri në vitin 1967 kur është bërë bartja e të njëjtës në pronësi shoqërore, I... B... apo pasardhësit e tij- këtu paditësit kanë parashtruar në procedurë administrative ndonjë kërkesë për anulimin e vendimit mbi shpronësimin e ngastrës. Zbatimi i kësaj dispozite në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se kërkesëpadia e paditëseve është e pabazuar.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditësve se të njëjtit nuk janë kompensuar dhe se aktvendimi për nacionalizim prodhon efekt juridik vetëm kur realizohet, kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës gjegjësisht aktvendimit për kompensimin e nacionalizimit të tokës ndërtimore të pa ndërtuar të dt. 18.03.1967 rezulton se paraardhësit të këtu paditësve I... B...-t i është paguar-kompensuar shuma prej 5,765.50 Euro aq sa është vlerësuar lartësia e kompensimit për tokën e nacionalizuar, fakte këto të konstatuar në pikën 2 dhe 3 të dispozitivit të atij aktvendimi, i cili nuk është kontestuar çoftë nga paraardhësi i paditësve apo edhe nga paditësit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4500/20, me datë 24.05.2024.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.